



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 306/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi– Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE “ Rona Farm ” Sh.p.k.-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me citostatik nga LE për nevojat e SHSKUK”, me numër të prokurimit: 220/19/2031/1/1/1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ SHSKUK, më datën 05.07.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik OE “ Rona Farm ” Sh.p.k.-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me citostatik nga LE për nevojat e SHSKUK”, me numër të prokurimit: 220/19/2031/1/1/1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ SHSKUK.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës me titull: “Furnizim me citostatik nga LE për nevojat e SHSKUK”, me numër të prokurimit: 220/19/2031/1/1/1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ SHSKUK, dhe lënda kthehet ne **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues OE “ Rona Farm ” Sh.p.k.-Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt: 10.04.2019

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt: 08.05.2019

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 08.05.2019.

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave është bërë me dt: 27.05.2019.

Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë me dt: 03.06.2019

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim është bërë me dt: 08.06.2019.

Operatori ekonomik ankues “ Rona Farm ” Sh.p.k.-Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 15.05.2019, me nr. 306/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me citostatik nga LE për nevojat e SHSKUK”, me numër të prokurimit: 220/19/2031/1/1/1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ SHSKUK, duke pretenduar se :

- Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 1, 6, 7, 59 dhe 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 17.06.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 25.06.2019, sqaron se pretendimi kryesor (dhe i vetëm) ankimorë në rastin konkret është se AK-SHSHKUK, gjatë vlerësimit të ofertave është dashtë të bëjë korrigjimin e normës së të TVSH-së të dhënë nga OE ankues në këtë rast prej 8%.

OE ankues pretendon se në rastin konkret për produktin “Imantinib” nuk aplikohet TVSH.

Ky pretendim ankimorë është i bazuar, dhe duke ju referuar Pyetjes dhe përgjigjes nr.46 të KRPP-së, Autoriteti Kontraktues ka qenë dhe është i obliguar që të bëjë korrigjimin e normës së TVSH-së, pa kërkuar sqarime tjera nga OE-të.

Në rastin konkret AK do duhej të bëjë korrigjimin e normës së TVSH-së, dhe të vazhdoj me vlerësim të mëtutjeshëm e ofertave.

Duke ju përgjigjur pretendimit të OE ankues, dhe për sqarim të autoritetit kontraktues, OSHP ka shqyrtuar raste të shumta ku ka trajtuar pikërisht këtë problem, i cili është identik me rastin konkret, korrigjimin dhe aplikimin e normës së duhur të TVSH-së, nga ana e AK-së.

Më poshtë gjeni pyetjen dhe përgjigjen e KRPP-së, lidhur me korrigjimin e normës së aplikueshme të TVSH-së, ku përgjigja e KRPP-së, është mjaft e qartë se si duhet vepruar në ato raste.

46. Si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-së, të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar (për arsyet që u ceken tek përgjigjet në pretendimet ankimore), ndërsa rekomandon që të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së, dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues /SHSKUK/, përmes parashtresës me shkrim të datës: 27.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik “ Rona Farm ” Sh.p.k.-Prishtinë, përmes parashtresës me shkrim të datës: 26.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 05.07.2019, ku kanë qenë prezent kryetari i paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, ekspertit shqyrtues i OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Namani deklaroj: pas njoftimit nga Autoriteti Kontraktues për rezultatit të tenderit në kemi pretenduar ligji i LPP-së dhe kemi bërë dhe kemi kërkuar rishqyrtim dhe prapë duke u thirrur në gabimet aritmetike në kemi vazhduar në OSHP. Në pajtohemi plotësisht me raportin e ekspertit shqyrtues.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi AK-së z. Krasniqi deklaroj: Autoriteti Kontraktues ka shpall tender publik për Citostatik me 04.04.2019, një ndër produktet ka qenë apo lot nr 1 furnizim me "Imatinil", pas hapjes kemi pas 4 OE me oferta kemi formuar komision profesional, komisioni ka rekomanduar OE me çmim me të lirë për dhënie të kontratës, pas kësaj kemi pranuar kërkesë për rishqyrtim nga OE ankues "Rona Farm" me arsyetimin që kemi bërë gabim në aplikimin e TVSH-se. Unë edhe tani mendoj se nuk ka interpretim apo udhëzim që tejkalon ligjin edhe nëse një OE ka dhënë çmim për njësi 1.09 për njësi dhe pas rregullimit të TVSH-se del 2.83, ajo nuk mund të quhet ndryshe vetëm gabim aritmetikor. Për veç kësaj pika kryesore OE ka bërë ankese profesionale detale të cilat i ka specifikuar në mënyrë detale ku prej vitit 2015, është rregullorja që mund të rregullohet gabimi i aplikimit të tarifës së TVSH-së, me qëllim që të jem i saktë në këtë seancë dua të informoj se me 14.08.2018, OE "Rona Farm" ka nënshkruar kontratë me të njëjtin Produkt, Kontrata ka qenë me nr 2006-18-074-1-1-1 dhe ka aplikuar tarifën e TVSH-se 8% pyetja është kujt ia ka paguar këtë TVSh OE në këtë rast? Them se kjo është e qëllimshme sepse të aplikojnë TVSH-në, nëse del me çmim me të lirë nuk ankohen askund ndërsa nëse del dikush me shtrenjete bene kërkesë dhe ankese që të rregullohet TVSH-ja, dhe prapë ta fitoj tenderin në fjalë. Në këtë rast besoj që ka mundur të qet në lajthitje Autoriteti Kontraktues QKUK.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertit shqyrtues z. Halili deklaroj: Qëndroj fuqishëm prapa raportit të dhënë në ekspertizë të datës 25.06.2019 norma e TVSH-së, nuk është gabim aritmetikor kjo është vërtetuar me shumë vendime të OSHP-së në të kaluarën dhe propozoj që lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së ankuese z. Namani deklaroj: I propozojmë panelit që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Krasniqi deklaroj: Kërkojmë nga OSHP se kur kemi prova ku është bërë gabim i qëllimshëm me aplikimin e TVSH-se mos të aprovohen ankesat e OE-ve ankuese dhe propozojmë që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoriteti Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se pretendimi kryesor (dhe i vetëm) ankimorë i OE ankues “ Rona Farm ” Sh.p.k.-Prishtinë, është se autoriteti kontraktues SHSKUK, gjatë vlerësimit të ofertave është dashtë të bëjë korrigjimin e normës së TVSH-së të dhënë nga OE në fjalë në këtë rast prej 8%. Ndërsa OE ankues “ Rona Farm ” Sh.p.k.-Prishtinë, pretendon se në rastin konkret për produktin “Imantinib” nuk aplikohet TVSH.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimi i lartpërmendur është i bazuar për faktin se duke ju referuar Pyetjes dhe përgjigjes nr.46 të KRPP-së, Autoriteti Kontraktues ka qenë dhe është i obliguar që të bëjë korrigjimin e normës së TVSH-së, pa kërkuar sqarime tjera nga OE-të.

Në rastin konkret AK do duhej të bëjë korrigjimin e normës së TVSH-së, dhe të vazhdoj me vlerësim të mëtutjeshëm e ofertave.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se duke ju përgjigjur pretendimit të OE ankues, dhe për sqarim të autoritetit kontraktues, OSHP ka shqyrtuar raste të shumta ku ka trajtuar pikërisht këtë problem, i cili është identik me rastin konkret, korrigjimin dhe aplikimin e normës së duhur të TVSH-së, nga ana e AK-së, në vijim gjeni pyetjen dhe përgjigjen e KRPP-së, lidhur me korrigjimin e normës së aplikueshme të TVSH-së, ku përgjigja e KRPP-së, është mjaft e qartë se si duhet vepruar në ato raste. 46. Si të vepohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-së, të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-së, është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-së, pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pas në dispozicion si dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues /SHSKUK/, gjatë zbatimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektua nenet 7, 59 dhe 60 të LPP-së. Prandaj obligohet autoriteti kontraktues KK-/SHSKUK/, që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave ligjore të zbatueshme për këtë aktivitet të prokurimit dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues obligon AK-ne qe te njoftoj MPB konform nenit 130 te LPP-se lidhur me kontratën e mëparshme për këtë lloj te aktivitetit te prokurimit.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuhi Paçarizi



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – SHSKUK.

1x1 OE –“ Rona Farm ” Sh.p.k.-Prishtinë,

1x1 Arkives se OSHP-se

1x1Për publikim në web- faqe të OSHP-së.